



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ**

Adresa:Fushë-Arrëz ,rruga qender,email:info@bashkiafushearrez.gov.al

Nr. 916 prot.

Fushë-Arrëz, më 18/03 /2026

PROJEKT-VENDIM

Nr. 13 , date 18.03 .2026

“PËR

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.8, DATË 27.02.2026 DHE PROT NR 605, DATË 27.02.2026, “PËR MIRATIMIN E NIVELIT TE PAGAVE TE ADMINISTRATES SE BASHKISE FUSHE-ARREZ, NJËSIVE ADMINISTRATIVE, INSTITUCIONEVE TE VARESISE DHE FUNKSIONEVE TE DELEGUARA PER VITIN 2026”, (PUNONJESIT E ARSIMIT BAZE, KOPEST, QKF)”.

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni “64” germa “J”, neni “55”, Ligjit 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”, Ligji nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në Institucionet e administratës publike, si dhe pages bazë minimale në shkallë vendi, VKM nr. 326, date 31.5.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike", i ndryshuar me VKM nr. 87, date 06.02.2026 “Per disa ndryshime në vendimin nr. 326, date 31.05.2023, të Keshillit të Ministrave , për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të Administratës Publike”, VKM nr. 776, date 19.12.2025, "Per përcaktimin e pages minimale në shkallë vendi", VKM nr. 127, date 27.02.2026, “Per Disa Ndryshime në Vendimin nr. 425, date 26.06.2024 të Keshillit të Ministrave ,”Per Miratimin e Strukturës dhe të nivelit të

pagave te punonjesve mesimore dhe te punonjesve te tjere jomesimor ne Institucionet Arsimore dhe ne Institucionet Plotesuese te Sistemit Arsimor Parauniversitar”, Këshilli i Bashkise Fushë Arrëz në mbledhjen e tij të rradhes mori në shqyrtim projekt vendimin e paraqitur nga Kryetari I Bashkise Fushe-Arrez dhe pas diskutimit nga Keshilltaret:

VENDOSI:

1. Te miratojë ndryshimin e nivelit te pagave të Arsimit Baze (Kopeshtit, QKF) sipas tabelave bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Burimeve Njerezore dhe Drejtoria e Financës.
3. Efektet financiare te këtij Vendimi fillojnë nga data 1 Janar 2026 deri me 31 Dhjetor 2026.
4. Ky Vendim hyn ne fuqi sipas përcaktimeve te nenit 55, pika 6 e ligjit 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”.

PARAQITEN PROJEKTIN

DREJTOR I BURIMEVE NJEREZORE

Fationa SELIMAJ

JURISTE

Redona HASANI

KRYETARI

Hil CURRI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ

Adresa: Fushë-Arrëz, rruga qender, email: info@bashkiafushearrez.gov.al

Nr. 916/3 prot.

Fushë-Arrëz, më 18 03 /2026

RELACION

Lënda: Per nje ndryshim ne Vendimin nr.8 date 27.02.2026 dhe prot nr.605, date 27.02.2026, "Per Miratimin e nivelit te pagave te Administrates se Bashkise Fushe-Arrez, Njesive Administrative, Institucioneve te varesise dhe funksioneve te deleguara per vitin 2026", (punonjesit e arsimit baze , Kopeshti, QKF)".

Drejtuar: KESHILLIT TE BASHKISE

FUSHE-ARREZ.

Të nderuar Këshilltarë!

Bashkia Fushë Arrëz në kuader te zbatimit te akteve ligjore dhe nënligjore te ndryshuara në lidhje me nivelin e pagave per te gjitha kategorite e punonjesve dhe nepunësve në Bashkine Fushe-Arrëz dhe Institucioneve ne vartesi te saj, paraqet këtë relacion.

Në zbatim te Ligjit nr. 139/2015, "Per veteqeverisjen vendore ", neni "64" germa "J", Ligjin 87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026", Ligjin nr. 35/2023, "Per kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve te tjera financiare dhe perfitimive te te punësuarve ne Institucionet e administratës publike, si dhe pages bazë minimale në shkalle vendi", VKM nr 87, date 06.02.2026, "Për disa ndryshime ne VKM nr.326, date 31.05.2023, per pagat e punonjesve mbeshtetes dhe punonjesve te tjere te specialiteteve te ndryshme ne disa Institucione te Administrates Publike", te ndryshuar, VKM nr. 425, date 26.06.2024 "Per miratimin e struktures dhe te niveleve te pagave te punonjesve mësimorë dhe të punonjësve te tjere jo mesimore ne Institucionet arsimore dhe ne Institucionet plotësuese te sistemit arsimore parauniversitar", VKM

nr. 776, date 19.12.2025, "Për percaktimin e pages minimale në shkalle vendi", VKM nr, 127, date 27.02.2026 "Per disa ndryshime ne VKM nr. 425, date 26.06.2024, te Keshillit te Ministrave,"Per miratimin e Struktures dhe te nivelit te pagave te punonjesve te tjere jomesimor ne institucionet arsimore dhe ne institucionet plotesuese te sistemit arsimor parauniversitar".

Bashkia Fushe Arrëz paraqiti këto ndryshime;

Kopeshti i Femijeve Fushë-Arrëz:

- 1- Drejtor Kopeshti me Ushqim 82,000 lekë, Lidhja 3
- 2- Edukatore ne Kopeshtin e Femijeve 61,000 lekë, Lidhja 3

Qendra Kulturore e Femijeve Fushë-Arrëz (QKF):

- 1- Drejtor i Qendres Kulturore te Femijeve 102,000 lekë, Lidhja 3
- 2- Pergjegjes Sektori ne Qendren Kulturore te Femijeve 76,000 lekë, Lidhja 3
- 3- Metodist ne ne Qendren Kulturore te Femijeve 63,000 lekë, Lidhja 3

-Shtesa për vjetërsi ne pune jepet ne masën:

1. 0,6% pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e para (1-10 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
2. 0,8% pas çdo viti pune per 10 (dhjete) vitet e dyta (11-20 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
3. 1% pas çdo viti pune për 10 (dhjete) vitet e treta (21-30 vite) he llogaritet mbi pagën e pozicionit.

Për efekt te llogaritjes së shteses së vjetersise, "vite pune" do të konsiderohet vjetersia e përgjithshme ne pune, e dokumentuar në librezën e punës së çdo punonjesi apo, ne mungesë te librezes se punes, me çdo dokument tjetër ligjor, te lëshuar nga organet kompetente perkatëse, sipas legjislacionit në fuqi, me perjashtim te viteve te sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, sherbimit ushtarak te detyrueshem, viteve te shkollimit ne institucionet e arsimit të larte dhe periudhës së trajtimit me pagese papunësie.

- Shtesa për vjetërsi në punë jepet në masën 1% pagesë bazë minimale dhe për klasë, por jo më shumë se 25 vjet. Për llogaritjen e kësaj shume njihet vjetërsia e përgjithshme në punë.

Përfshihen nga kjo llogaritje vitet e sigurimit vullnetar, vetëpunimit, shërbimit ushtarak për meshkujt, vitet e arsimit dhe periudha e trajtimit me pagesë papunësie.

Për këto ndryshime janë përdorur burime financiare nga transfertat specifike, transfertat e pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta për vitin 2026.

Sa më sipër kërkojmë nga ana juaj miratimin e këtij Projekt Vendimi në zbatim të Vendimeve të mësipërme.

Bashkëlidhur këtij material do të gjeni dhe Projekt Vendimin përkatës.

Faleminderit për mbështetjen dhe bashkëpunimin.

DREJTOR I BURIMEVE NJEREZORE

Fationa SELIMAJ

JURISTE

Redona HASANI

KRYETARI

Hil CURRI

